



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 893/5 Prot.

Tiranë, më 14.12.2020

V E N D I M

Nr.176, datë 14.12.2020

Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 2027/4 prot., datë 27.11.2020, për moskonfirmimin si “nëpunës civil” në përfundim të periudhës së provës të nëpunëses *** , për shkak të vlerësimit të rezultateve në punë në nivelin “Jo kënaqshëm” dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

VËREJ SE:

Nëpërmjet dy kërkesave të regjistruar me nr. 893 prot., datë 24.11.2020 dhe nr. 893/3 prot., datë 03.12.2020, nëpunësja civile në periudhë prove ***** , ka parashtruar pretendimin se për disa parregullsi të kryera ose të lejuara nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, gjatë kryerjes së procesit të vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e provës, duke sjellë si pasojë moskonfirmimin e saj si “nëpunës civil”.

Nga hetimi administrativ i kryer në këtë rast dhe pas analizës së dokumentacionit të çështjes, rezulton e vërtetuar që: Me vendimin nr. 250, datë 27.06.2019, të njësisë përgjegjëse të AKEP, ankuesja ***** është emëruar si nëpunëse civile në periudhë prove në pozicionin e punës “Specialist i Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm dhe Administrimit

database”, në Sektorin e Autorizimeve, në Drejtorinë e Autorizimeve, pranë AKEP. Në përmbajtje të këtij akti, përcaktohet se marrëdhëniet financiare do të fillojnë në datën 07.07.2019.

Në lidhje me procesin e trajnimit të detyrueshëm, rezulton se, me aktin nr. 254, datë 28.06.2019, të Kryetarit të AKEP, “Për nëpunësin në periudhë prove *****”, është urdhëruar:

- *“kryerja e ciklit të detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP), nga nëpunësja *****, nëpunës civil në pozicionin Specialist i Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm dhe Administrimit të database, në Drejtorinë e Autorizimeve;*
- *Caktimin si mbikëqyrës ***** nëpunës civil, pranë Drejtorisë së Autorizimeve, sipas legjislacionit në fuqi”.*

Në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton se nëpunësja ***** ka ndjekur programin e detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës pranë ASPA, gjatë periudhës 22 shtator – 5 tetor 2020 dhe në përfundim të saj, është pajisur me certifikatë, nga ku rezulton të jetë vlerësuar me 24 pikë.

Në kuadër të procesit të verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave si dhe aftësive dhe dobësive të nëpunësit për kryerjen e detyrave, si dhe në zbatim të përcaktimeve të nenin 24, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kreut VI, pika 6, germa b), të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” dhe Kreut II, pika 1, germa b), të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, për nëpunësen ***** është kryer vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën e provës (për periudhën 01.07.2019 – 11.11.2020), i cili i është paraqitur për njohje nëpunëses në datën 17.11.2020.

Nga përmbajtja e formularit të vlerësimit të rezultateve të punës, nëpunësja është njohur me vlerësimin e punës në nivelin 4, “Jo kënaqshëm”. Nga këqyrja e këtij akti, ankuesja ka konstatuar se rubrika “Nënshkrimi”, në ndarjen D, nuk ka qenë e plotësuar me nënshkrimin e zyrtarit autorizues, si dhe mungonte shënimi për datën e kryerjes së vlerësimit prej zyrtarit raportues dhe kundërfirmues. Duke mos qenë dakord me këtë vlerësim, nëpunësja ka kërkuar rivlerësimin, duke nënshkruar në formularin standard të vlerësimit të rezultateve në punë, në pikën 5, të ndarjes D.

Më tej, me shkresën nr. 2027 prot., datë 18.11.2020, nëpunësja i është drejtuar njësisë së burimeve njerëzore, duke kërkuar vënien në dispozicion të formularit standard të vlerësimit,

me të cilin ishte njohur një ditë më parë, me qëllim të ushtrimit të së drejtës së ankimit. Pas vënies në dispozicion të këtij formulari, nëpunësja ka konstatuar se, zyrtari autorizues kishte kryer rivlerësimin brenda datës 17.11.2020, duke i mohuar në këtë mënyrë nëpunëses të drejtën e paraqitjes së provave dhe argumenteve kundër vlerësimit të dhënë.

Në zbatim të Kreut V, pika 1, të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, nëpunësja *****, nëpërmjet shkresës nr. 2027/1 prot., datë 20.11.2020, ka ankimuar vlerësimin e rezultateve në punë të kryer nga zyrtari raportues dhe kundërfirmues, duke kërkuar rivlerësimin.

Zyrtari autorizues, në kuptim të Kreut V, pika 2, të aktit nënligjor të sipërcituar, pasi ka shqyrtuar ankimin e nëpunëses dhe materialet shkresore të paraqitura prej saj, me vendimin nr. 222, datë 25.11.2020, *“Për shqyrtimin e ankimit në kuadër të vlerësimit të rezultateve në punë në shërbimin civil për nëpunësin civil në periudhë prove *****”*, ka vendosur mospranimin e ankesës, si të pabazuar në prova, fakte dhe në ligj.

Rezulton se, Drejtori i Drejtorisë së Autorizimeve, në cilësinë e eprorit direkt, në zbatim të pikës 7, germa c, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, me vendimin nr. 2027/4 prot., datë 27.11.2020, ka vendosur moskonfirmimin e nëpunëses ***** si nëpunës civil pas përfundimit të periudhës së provës.

Konstatohet se vendimmarrja e tij, është mbështetur në rezultatin e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në ASPA; formularin e vlerësimit të rezultateve individuale të nëpunëses gjatë periudhës së provës; si edhe në mendimin me shkrim të paraqitur nga nëpunësja *****; nëpërmjet memos së datës 10.11.2020.

Në përmbajtjen e shkresës së paraqitur nga nëpunësja mbikëqyrëse, rezulton se ajo ka parashtruar se ankuesja ***** ka treguar vështirësi në realizimin e detyrave të pozicionit të punës dhe se nuk është konsultuar apo njohur me dokumentacionin e nevojshëm, me qëllim realizimin e detyrave brenda afateve dhe sipas kriterëve ligjore.

Pas marrjes dijeni të vendimit për moskonfirmimin si nëpunëse civile, në përfundim të periudhës së provës, nëpunësja ***** ka ushtruar të drejtën e ankimit me shkresën nr. 2027/5 prot., datë 04.12.2020, në përputhje me përcaktimet e Kreut VI, pika 14, të aktit nënligjor nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave. Njëkohësisht, nëpërmjet shkresës nr. 2027/6 prot., datë 04.12.2020, kjo nëpunëse ka kërkuar nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit, njohjen me vendimin për caktimin e nëpunëses *****; si nëpunës mbikëqyrës, duke pretenduar jo vetëm se ky vendim nuk i është komunikuar asnjëherë, por së gjatë ushtrimit të detyrave funksionale të pozicionit të punës nuk ka pasur

asnjëherë komunikim me këtë punonjëse në rolin e udhëheqësit apo mbikëqyrësit, pasi këto udhëzime janë dhënë vetëm prej eprorit të saj direkt, nëpunësit ***** , me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Autorizimeve.

Me shkresën nr. 2027/7 prot., datë 09.12.2020, “*Kthim përgjigje shkresës tuaj nr. 2027/6 prot., datë 04.12.2020*”, Kryetari i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ka njoftuar nëpunësen ***** , se nëpunësi mbikëqyrës është caktuar me urdhrin nr. 254, datë 28.06.2019, duke i bashkëlidhur aktin administrativ.

Nisur nga sa më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit vlerëson se, zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues (*eprori direkt në rastin në fjalë*) dhe zyrtari autorizues (*titullari i institucionit*), si dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, nuk kanë treguar kujdesin e duhur për të zbatuar detyrimet ligjore që ju ngarkon neni 24 dhe 62, i ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në kryerjen e procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e provës, si dhe në procedurën për moskonfirmimin si “nëpunës civil” të ankueses *****.

Në përmbajtje të dispozitave që rregullojnë pranimin në shërbimin civil, përcaktohet se nëpunësi, që emërohet për herë të parë në shërbimin civil, i nënshtrohet një periudhe prove që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit. Detyrat që duhet të përmbushë nëpunësi dhe institucioni gjatë periudhës së provës, janë të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.

Në mbështetje të këtyre dispozitave ligjore, nëpunësi civil në periudhë prove është i detyruar të ndjekë programin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s dhe udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit e vendos eprori direkt. Nga ana tjetër, finalizimi i kësaj procedure bazohet në vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën e provës, proces i cili realizohet nga zyrtari raportues, zyrtari autorizues dhe zyrtari kundërfirmues, sipas përcaktimeve të Kreut I, pika 2, të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar dhe materializohet me nxjerrjen e vendimit të eprorit direkt për konfirmimin/ ose moskonfirmimin e nëpunësit civil.

Në lidhje me rastin konkret, Komisioneri konstaton se nuk janë respektuar dhe janë zbatuar gabim dispozitat ligjore që rregullojnë afatin dhe elementët procedurale të periudhës së provës, ashtu siç argumentohen në vijim:

Së pari, rezulton se, nuk janë respektuar dispozitat në lidhje me caktimin e nëpunësit mbikëqyrës për nëpunësin civil në periudhë prove. Në Kreun VI, pika 4, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, përcaktohet se nëpunësi më i vjetër civil caktohet nga eprori direkt i nëpunësit në periudhë prove. Gjatë periudhës së provës, nëpunësi mbikëqyrës duhet të japë udhëzime dhe orientime me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale nga nëpunësi civil në periudhë prove, të cilat për efekt provueshmërie duhet të jenë të materializuara me prova shkresore.

Nga dokumentacioni shkresor i administruar në kuadër të hetimit administrativ, rezulton se nga nëpunësi mbikëqyrës është përgatitur memo e datës 10.11.2020, e cila rezulton të mos jetë shoqëruar me asnjë dokumentacion që të vërtetohen:

- udhëzimet që i janë dhënë nëpunëses civile në periudhë prove *****;
- periudhën kohore kur janë dhënë udhëzimet/orientimet apo bisedat/takimet e realizuara midis tyre, ashtu si e kërkon ligji;
- ku kanë konstatuar vështirësitë apo problematikat gjatë kryerjes së detyrave funksionale, të cilat në një rast të vlerësimit negativ duhet të përfshijnë të gjithë periudhën kohore, gjatë së cilës nëpunësja është në provë.

Nga analiza e akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, në lidhje me aspektin që po trajtojmë, rezulton që nëpunësja ***** të mos ketë pasur dijeni në lidhje me veprimin administrativ për caktimin e punonjësit mbikëqyrës.

Nga institucioni Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Komisionerit i është vënë në dispozicion urdhri nr. 254, datë 28.06.2019, i ish - Kryetarit të AKEP, “*Për nëpunësin në periudhë prove ******”, nga përmbajtja e të cilit rezulton se në cilësinë e nëpunësit mbikëqyrës është caktuar nëpunësja *****.

Urdhri i mësipërm përbën një akt administrativ dhe si i tillë, në kuptim të nenit 104, pika 1, të ligjit 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, fillon të sjellë pasoja juridike ndaj palës së cilës i drejtohet, me njoftimin e përmbajtjes së aktit palëve. Sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror duhet të evidentohen në regjistrin e korrespondencës, me qëllim që të evidentohet edhe marrja dijeni në lidhje me dokumentin shkresor.

Në rastin konkret, rezulton se urdhri për caktimin e nëpunësit mbikëqyrës është nxjerrë në datën 28.06.2019, para momentit të fillimit të marrëdhënies së punës dhe asaj financiare për nëpunësen ***** (e cila është data 01.07.2019). Në dokumentacionin e administruar pranë Komisionerit, dërguar nga institucioni, nuk rezulton i provuar fakti që

ankuesja të ketë marrë dijëni në lidhje me këtë veprim administrativ, fakt i cili vërtetohet edhe nëpërmjet kërkesës së saj nr. 2027/6 prot., datë 04.12.2020, drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, nëpërmjet të cilës ka kërkuar njohjen me urdhrin për caktimin e mbikëqyrësit dhe nga përgjigja e institucionit, i cili i ka vënë në dispozicion vetëm aktin, por asnjë dokument tjetër që të provojë nënshkrimin e saj në librin e shpërndarjes së dokumentacionit në institucion, apo nënshkrimin e punonjësës mbikëqyrëse që ka marrë dijëni për këtë akt.

Kjo nëpunëse ka ardhur në dijëni të punonjësit të emëruar si nëpunësi mbikëqyrës vetëm pas njoftimit të vendimit nr. 2027/4 prot., datë 27.11.2020, të eprorit direkt për moskonfirmimin si nëpunës civil, në përfundim të periudhës së provës, si dhe memos së datës 10.11.2020.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në konkluzionin se, memo e përgatitur nga nëpunësja *****, është një akt i cili nuk ka dalë në përmbushje të procedurave ligjore dhe kërkesave specifike që i janë ngarkuar nëpunësit mbikëqyrës nga ligji dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë aspekt dhe nuk pasqyron me objektivitet dhe bazuar në prova konkrete, nivelin e përmbushjes apo jo të detyrave funksionale prej nëpunësit civil në periudhë provë *****.

Së dyti, rezulton se nuk është respektuar afati ligjor i periudhës së provës, ku sipas nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kjo periudhë zgjat 1 vit nga data e aktit të emërimit.

Rezulton se, nëpunësja ***** është emëruar nëpunës civil në periudhë prove me aktin nr. 250, datë 27.06.2019, në përmbajtje të të cilit është përcaktuar se marrëdhëniet financiare do të fillojnë në datën 01.07.2019. Sipas përcaktimeve të mësipërme ligjore, periudha e provës duhet të kishte mbaruar në datën 01.07.2020, por vendimmarrja e eprorit direkt në lidhje me moskonfirmimin e kësaj nëpunëse si nëpunës civil është marrë në datën 27.11.2020.

Rezulton se, zgjatja e periudhës së provës ka ardhur për shkak të mos kryerjes së trajnimit të detyrueshëm pranë ASPA, brenda këtij afati kohor, si pasojë e masave kufizuese të ndërmarra në kuadër të parandalimit të përhapjes së virusit COVID-19. Për këtë arsye, rezulton që trajnimi i detyrueshëm pranë ASPA është kryer në periudhën 22 shtator – 5 tetor 2020, nga ku rezulton se kjo nëpunëse është vlerësuar me 24 pikë.

Megjithatë, në dokumentacionin e sjellë nga AKEP, nuk rezulton që eprori direkt, të ketë vendosur zgjatjen e afatit të periudhës së provës, fakt që vjen në kundërshtim me përcaktimet e Kreut VI, pika 7, germa b, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave,

“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, në të cilin përcaktohet se: “... eprori direkt është i detyruar të vendosë:

b) Zgjatjen një herë të vetme deri në 6 (gjashtë) muaj të periudhës së provës, në rast të mospërfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm në ASPA, pamundësisë së vlerësimit të plotë të nëpunësit, në rast se eprorit...”.

Në kushtet kur, eprori direkt ka qenë në pamundësi të vlerësimit të plotë të nëpunëses ***** , për shkak të pamundësisë për ndjekjen e programit të detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës, ky i fundit duhet të kishte nxjerrë aktin administrativ për shtyrjen e afatit të periudhës së provës për këtë nëpunëse. Mosrealizimi i kësaj procedure në rastin konkret, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, nga data e përfundimit të periudhës së provës, në kuptim të Kreut VI, pika 8, të aktit nënligjor të sipërcituar përbën “mospërbushje detyrë”, nga eprori direkt.

Së treti, konstatohet se, vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën e provës për nëpunësen ***** nuk është kryer në përputhje me procedurën dhe kërkesat ligjore. Në Kreun VI, pika 6, germa b, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, përcaktohet se, vlerësimi i rezultateve individuale për nëpunësin civil në periudhë prove bëhet sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për vlerësimin e arritjeve vjetore.

Në kuptim të përcaktimeve të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civile”, i ndryshuar, vlerësimi i rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës është vjetor dhe llogaritet nga data e emërimit të nëpunësit civil në detyrë.

Sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i rëndësishëm, i cili konsiston në verifikimin e realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive dhe dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave. Ai i shërben përmirësimit të aftësive profesionale të nëpunësit civil dhe të cilësisë së shërbimit dhe ka pasoja të rëndësishme për nëpunësin civil, pasi shërben për të marrë vendime objektive në lidhje me periudhën e provës, mundësinë e zhvillimit të karrierës nëpërmjet ngritjes në detyrë, lirim nga shërbimi, përparimin në hapat e pagës si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

Për realizimin e një vlerësimi sa më objektiv, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”, është përcaktuar dhe procedura që duhet të respektohet për procesin e vlerësimit të rezultateve në punë si dhe kompetencat për vlerësimin. Në kuptim të pikës 12, Kreut II, të këtij akti

nënligjor, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i vazhdueshëm, i cili konsiston në tri faza:

- Planifikimi, ku zyrtari raportues, përcakton objektivat kryesorë të punës dhe sjelljet përkatëse profesionale që bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, përmbushjen e objektivave dhe të misionit të institucionit. Në fazën e planifikimit përfshihet përgatitja e objektivave dhe e një plani veprimtarish për arritjen e objektivave kryesore. Objektivat kryesorë të punës duhet të jenë të matshëm, kurse veprimet të dukshme. Në këtë fazë zyrtari raportues dhe nëpunësi që do të vlerësohet diskutojnë së bashku qëllimet e nëpunësit për karriere, aspiratat dhe çdo gjë tjetër që lidhet me trajnimin dhe zhvillimin profesional.

- Bisedimet e ndërmjetme. Në mes të periudhës së vlerësimit, zyrtarët raportues takohen me secilin prej nëpunësve që do të vlerësohet për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuara për të shprehur mendime dhe për të dhënë komente, si dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim.

- Vlerësimi përfundimtar, gjatë vlerësimit përfundimtar të rezultateve në punë, zyrtari raportues bën një vlerësim të përmbledhur të suksesit të nëpunësit që do të vlerësohet në arritjen e objektivave kryesore të punës, të përcaktuara në fazën e planifikimit dhe të rishikuar gjatë bisedimeve të ndërmjetme.

Në kushtet kur vlerësimi i rezultateve në punë kryhet për periudhën e provës, fazat e mësipërme duhet të shtrihen përgjatë gjithë afatit 1 vjeçar, nga data e emërimit të nëpunësit civil në periudhë prove.

Për vlerësimin e kryer në rastin konkret, nuk rezulton të ketë një dokumentacion që të materializojë zhvillimin e fazës së planifikimit, në të cilën duhet të ishin identifikuar objektivat kryesore të punës dhe sjelljet profesionale që duhet të përmbushte nëpunësja apo gjurmë të shkruara.

Nga aktet e vëna në dispozicion, rezulton se nëpunësja ***** me detyrë “Përgjegjës i Sektorit të Autorizimeve”, në rolin e zyrtarit raportues, ka qenë me lejen e lindjes që nga momenti i emërimit të nëpunëses ***** deri në datën 16.09.2019. Për këtë fakt, kjo nëpunëse nuk ka mundur objektive të kryejë vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën 01.07.2019-16.09.2019, për shkak të mungesës së justifikuar në punë. Nga ana tjetër, nuk ka asnjë dokument shkresor, që të vërtetojë se faza e planifikimit është kryer nga eprori direkt, në mungesë të zyrtarit raportues.

Në vijim të këtij arsyetimi, nuk vërtetohet të jenë zhvilluar as fazat e tjera të vlerësimit, të parashtruara më sipër, pasi Komisioneri nuk ka administruar asnjë provë që të vërtetojë të kundërtën.

Për më tepër, në provat e administruara nga Komisioneri, rezultojnë një formular i vlerësimit të pjesshëm të punës, për një periudhë 6 mujore, ku ankuesja është paraqitur në nivele të larta vlerësimi për punën e kryer.

Për të gjitha këto arsye, arrihet në përfundimin se komentet e dhëna në formularin standard të vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e provës, përbëjnë një vlerësim fiktiv, të pabazuar në prova dhe në fakte dhe në mungesë të evidentimit të punës reale të kryer nga nëpunësja *****, e cila ka paraqitur pranë Komisionerit fakte që tregojnë se prej saj janë realizuar punë që pretendohen si të pa kryera në aktet që kanë dalë për mos konfirmimin e saj si nëpunëse civile.

Së katërti, rezultojnë se Kryetari i AKEP, ka rivlerësuar nëpunësen *****, duke mos kryer një hetim të plotë administrativ ndaj pretendimeve të saj në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën e provës.

Nga praktika shkresore e kësaj procedure, rezultojnë se, nëpunësja ***** nuk ka qenë dakord me vlerësimin e dhënë ndaj saj dhe për këtë arsye në datën 17.11.2020 ka kërkuar rishqyrtim të vlerësimit nga zyrtari autorizues, duke nënshkruar ndarjen **D**, “Nënshkrimi”, të formularit standard. Rezultojnë se, nëpunësi autorizues, brenda të njëjtës ditë, ka kryer rivlerësimin duke deklaruar se është dakord me vlerësimin e kryer nga eprori direkt, fakt që pasqyrohet në ndarjen **DH**, “Rivlerësim nga zyrtari autorizues”.

Vlerësohet se, procesi i rivlerësimit është konsideruar formal dhe nuk është trajtuar me kujdesin dhe seriozitetin e duhur nga titullari i institucionit/zyrtari autorizues, i cili duke mos lejuar nëpunësen të paraqesë pretendimet, faktet dhe provat shkresore brenda afatit 5 ditor, ka lejuar kryerjen e një rivlerësimi jo objektiv dhe jo të plotë në lidhje me pretendimet e kësaj nëpunëseje.

Pavarësisht rivlerësimit të mësipërm, ankuesja rezultojnë t’i jetë drejtuar zyrtarit autorizues me shkresën nr. 2027/1 prot., datë 20.11.2020, nëpërmjet të cilës ka parashtruar të gjitha argumentet ligjore si dhe provat shkresore, duke kërkuar deklarimin e pavlefshmërisë së vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e provës.

Me vendimin nr. 222, datë 25.11.2020, Kryetari i AKEP ka refuzuar ankesën e mësipërme, duke pretenduar se nëpunësja ***** nuk ka paraqitur argumentet dhe provat e nevojshme për një rivlerësim, të secilës prej detyrave funksionale, sipas pozicionit të punës.

Duke analizuar përmbajtjen e këtij vendimi si dhe të gjitha dispozitat ligjore që rregullojnë procesin e ankimit administrativ, Komisioneri konkludon se, vendimmarrja e zyrtarit autorizues nuk është rezultat i një hetimi të plotë dhe të paanshëm administrativ. Në

këtë përfundim arrihet për faktin se në asnjë moment, nuk janë analizuar provat shkresore, që ka paraqitur ankuesja, të cilat kanë diktuar në kryerjen e këtij rivlerësimi. Për më tepër, rezultoni se zyrtari autorizues nuk ka analizuar dhe shqyrtuar pretendimet e paraqitura nga nëpunësja, por është mjaftuar duke parashtruar si argumente po të njëjtat fakte të paraqitura në formularin standard të vlerësimit.

Nisur nga sa është analizuar më sipër dhe në referencë të dispozitave të mësipërme ligjore të përmendura rast pas rasti, arrihet në përfundimin se procedura e vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësen civile në periudhë prove ***** nuk është bërë sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, fakt i cili i jep atyre një përmbajtje subjektive e që nuk përputhet me qëllimin për të cilin është krijuar dhe funksionon instituti i vlerësimit të periudhës së provës.

Kjo, në kuptim të nenit 109, pika “b”, “d” dhe “dh”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, e bën formularin standard të vlerësimit akt administrativ të paligjshëm dhe për këto arsye, në referencë të nenit 114, pika 1, të po këtij ligji, ky akt duhet të anulohet.

Me anulimin e këtij akti, titullari i institucionit, në cilësinë e zyrtarit autorizues për nëpunësen *****, si dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të AKEP, duhet të marrin masa për përsëritjen e këtij procesi, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të tij.

Në vijim të trajtimit të mëtejshëm të rastit në fjalë, me anulimin e formularit standard të vlerësimit të rezultateve në punë, si një akt i paligjshëm, Drejtori i Drejtorisë së Autorizimeve, në cilësinë e eprorit direkt, duhet të shfuqizojë aktin nr. 2027/4 prot., datë 27.11.2020, “Për moskonfirmimin e nëpunësit *****, si nëpunës civil, në përfundim të periudhës së provës”, si një akt i paligjshëm, i nxjerrë në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si dhe nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të këtij institucioni, të marrin masa për anulimin e formularit standard të vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësin civil në periudhë prove *****, si akt i paligjshëm i nxjerrë në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin për nëpunësin civil.
2. Kryetari i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si dhe personat e ngarkuar nga ligji për kryerjen e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, duhet të përsërisin procesin e vlerësimit për periudhën e provës, për nëpunësin *****, duke respektuar fazat përkatëse të vlerësimit dhe shoqëruar me dokumentacionin përkatës që materializon zhvillimin e këtyre fazave dhe duke e shoqëruar me dokumentacionin shkresor.
3. Drejtori i Drejtorisë së Autorizimeve, në cilësinë e eprorit direkt, duhet të shfuqizojë vendimin nr. 2027/4 prot., datë 27.11.2020, *“Për moskonfirmimin e nëpunësit *****, si nëpunës civil, në përfundim të periudhës së provës”*, si një akt i paligjshëm, i pabazuar në prova dhe fakte, dhe nxjerrë në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.
4. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit duhet të tregojë kujdes në të ardhmen, të bashkërendojë punën me zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, me qëllim që të sigurohet:
 - kryerja e procesit të vlerësimit brenda afateve ligjore;
 - njoftimi i nëpunësit dhe dokumentimi i këtij fakti, në lidhje me të gjitha aktet administrative që dalin gjatë periudhës së provës, që kanë lidhje me realizimin e procedurave ligjore të përcaktuara që duhet të respektohen gjatë kësaj periudhe specifike, të tilla si akti për njohjen me nëpunësin mbikëqyrës, përcaktimi i objektivave, dokumentimi i fazave të procesit të vlerësimit në një dosje të veçantë, e aspekte të tjera të kësaj natyre;
 - njoftimi i nëpunësit për rezultatin e vlerësimit brenda afatit ligjor, me qëllim garantimin e ushtrimit të së drejtës së rivlerësimit ose ankimit prej tij, pranë organeve kompetente;
 - objektiviteti i procesit të vlerësimit, duke pranuar aktet e vlerësimit, për t'i administruar në dosjen e personelit, vetëm nëse këto akte janë plotësuar sipas kërkesave ligjore dhe shoqërohen me dokumentacionin përkatës.
5. Për kryerjen e veprimeve administrative, lihet afat 20 ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.

6. Me kalimin e këtij afati, institucioni Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është i detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
7. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
8. Të njoftohen për këtë vendim, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, e cila duhet të njoftojë të gjithë aktorët që realizojnë procesin (*zyrtarin raportues, zyrtarin kundërfirmues (eprori direkt) dhe zyrtarin autorizues (titullari i institucionit)*), si dhe nëpunësja
*****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha